




REPUBLIKA E KOSOVË / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT / AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE / ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. _____	Nr. Prot. _____
Dep. _____	Br. Prot. _____
Dep. _____	Prot. No. 03-02/3445
Nr. i faq _____	Data _____
Broj, stranica _____	Datum 24.10.2017
Nr. pages 02	Date _____
PRISHTINË	



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 23.10.2017, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me Nr. AKK-03-02-2529-17, për Zyrtarin e lartë z.Sami Latifi-Këshilltar komunal në Kuvendin Komunal të Mitrovicës, për shkak se është shmangur situata e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik, me Nr. AKK-03-02-2529/17, për Zyrtarin e lartë, z.Sami Latifi, Këshilltar komunal në Komunen e Mitrovicës, dhe njëkohësisht person i autorizuar në biznes privat, është trajtuar sipas procedurave të Ligjit për Parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Fillimisht, Agjencia kundër Korrupsionit ka bërë shkresë njoftuese zyrtarit të lartë z.Sami Latifi (DPK-03-02-2703-17), dhe pastaj ai ka kontaktuar Agjencinë kundër Korrupsionit, me ç'rast është njoftuar me situatën në të cilën ndodhet, si dhe me ndryshimet që duhet të bëjë, për të shmangur situatën e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit të tij publik.

Zyrtari i lartë, z.Latifi është deklaruar se se për rastin të cilin e ka identifikuar AKK-ja ai ka menduar se duke qenë si biznes pasiv nuk përbën konflikt interesi.

Ndërkohë, z.Latifi, i ka bërë ndryshimet e nevojshme dhe në Agjencinë kundër Korrupsionit, ka sjellë informacionet mbi ndryshimet në biznesin D.P.Sh.“Mitrovica Phone 1”(DPK/Dpki-03-02/3354/17) të bëra në Agjencionin për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (ARBK), në të cilin shihet se, z.Sami Latifi tashmë ka hequr dorë edhe nga pronësia edhe nga funksioni menaxhues në këtë biznes privat, me çka ka shmangur konfliktin e interesit në ushtrimin e funksionit të tij publik.

II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK-së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Drejtore e Agjencisë kundër Korrupsionit


/ Shaip Havolli /